



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ

Adresa:Fushe-Arrez,Prefektura Shkoder,Tel:027123131,Email:info@bashkiafushearrez.gov.al

Fushe-Arrez me, 22/11/2023

Procesverbal -Tipi i kontrates - Sherbim

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashk dokumentat e tenderit)

**OBJEKTI I PROCEDURËS - “Sherbim furnizimi me dru zjarri dhe blerje peleti per
institucionet ne varesi te Bashkise Fushe-Arrez”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
03400000-4**

VLERA E FONDIT LIMIT – 1 582 980 (nje milion e peseqind e tetedhjetë e dy mije e nenteqind e tetedhjetë) **leke pa TVSH.**

Në bazë të nenit 77, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 43 , autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Fushë-Arrez**, ka hartuar procesverbalin për argumenimin dhe miratimin e specifikimeve tenike dhe kriterëve për kualifikimin për procedurën e sipercituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 vitet e fundit financiare, ku vlera e xhiros minimale nuk mund të tejkalohet **40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës**.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 pika 2 germa c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar.

Ky kriter i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 pika 3 e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” në zbatim të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formes elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.2 Për të provuar përvojën e mëparshme, operatorët ekonomik duhet të paraqesin dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë jo më e madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku shënohen vlerat, afati i përfundimit të kontratës ose fature tatimore të shitjes, ku shënohen data, shumat dhe shërbimet e realizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4 germa b të VKM nr.285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të madhe se 20% të vlerës së fondit limit,që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **6 persona**, për muajin e fundit nga data e zhvillimit të tenderit, të vërtetuar me:

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për muajin e fundit nga data e zhvillimit të tenderit.

- Listpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për muajin e fundit nga data e zhvillimit të tenderit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur bazuar në pikën 4, të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 ”Për prokurimin publik” dhe nenit 41 pika 4 germa b dhe c të VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që OE të kenë stafin teknik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Numri i punonjësve të kërkuar është vendosur bazuar në preventivin e AK, në të cilin parashikohen zëra shërbimesh si: prerje, coptim, transport, stivim në magazine (dru zjarri).

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë mjetin e mëposhtme:

Nr.	Mjetet	Sasia	Gjendja
1	Mjet transporti , kamion mbi 10 ton	1	Pronësi ose me qira

Kamion mbi 10 ton, për mundësi lëvizje në rrugë rurale/interurbane për kryerjes e shërbimit të furnizimit.

Për mjetet me status përdorimi qira/hua përdorje të disponohet kontrata noteriale perkatese mes qiradhenesit dhe qiramarresit.

Për këtë mjet duhet të paraqesi leje qarkullimi, akt kolaudimi, sigurimin e detyrueshëm të mjeteve, leje dhe licence transporti.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e zerave te preventivit të publikuar ne SPE.

2.3.3 Operatori Ekonomik per realizimin e kontrates duhet te disponoje:

- Motosharra 2 (dy) cope
- Veshje mbrojtese + skafande 6 (kater) cope
- Puntore te thjeshte 6 (kater)

Drejtues mjete transporti 1 (nje), i pajisur me leje drejtimi + deshmi aftesie.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e zerave te preventivit të publikuar ne SPE.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.